

## SKEMA PËR VLERËSIM TË TESTIT NGA GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA PAS PËRFUNDIMIT TË KLASËS IX, MAJ 2015

### DETYRA 1.

**1 pikë** – nëse nxënësi/nxënësja ka shkruar MONSTAT ose Enti për Statistika  
**0 pikë** - të tjera (është shkruar ndonjë përgjigje tjetër ndryshe nga ajo që është kërkuar, nuk është dhënë asnjë lloj përgjigjeje)

### DETYRA 2.

**1 pikë** - është rrethuar përgjigjja **3. Shavniku dhe Podgorica**  
**0 pikë** - të tjera (është rrethuar përgjigjja 1, 2 ose 4, janë rrethuar dy ose të katër përgjigjet, nuk është rrethuar asgjë)

### DETYRA 3.

- A) 1 pikë** - është rrethuar përgjigjja: **4. Rajoni qendror**  
**0 pikë** - të tjera (është rrethuar përgjigjja 1, 2 ose 3, janë rrethuar dy ose të katër përgjigjet, nuk është rrethuar asgjë)
- B) 1 pikë** - nëse nxënësi/nxënësja ka shkruar: **55,8%**  
**0 pikë** - të tjera (është shkruar ndonjë përgjigje tjetër ndryshe nga ajo që është kërkuar, nuk është dhënë asnjë lloj përgjigjeje)
- C) 1 pikë** – nëse nxënësi/ nxënësja ka shkruar: **Veriu (Rajoni i veriut)**  
**0 pikë** - të tjera (është shkruar ndonjë përgjigje tjetër ndryshe nga ajo që është kërkuar, nuk është dhënë asnjë lloj përgjigjeje)

**Gjithsej 3 pikë**

### Detyra 4.

**2 pikë** – nëse nxënësi/nxënësja ka shkruar saktë përemrat vetor ose trajtën e shkurtër të duhur në fjalitë:

Dëshiroj nga **ju** të më lini rehat.

Gjithashtu edhe **neve** do të na vijë keq po të largohesh.

Ai është i rëndësishëm për **ne**.

Njerëzve **u** kam ofruar shumë ndihmë.

**1 pikë** – për të paktën dy përgjigje të sakta

**0 pikë** - të tjera (është vendosur vetëm një përemër ose trajtë e shkurtër e saktë, është shkruar ndonjë përgjigje tjetër ndryshe nga ajo që është kërkuar, nuk është dhënë asnjë lloj përgjigjeje)

#### **Detyra 5.**

**3 pikë** – nëse nxënësi/nxënësja ka shkruar: Emrin e dërguesit, marrësit, kohën dhe vendin e mbajtjes së festimit. Teksti i ftesës duhet të jetë një fjali ose më shumë fjali që kanë saktësi gramatikore.

**2 pikë** – nëse është harruar vetëm një nga këto të dhëna

**1 pikë** - janë harruar dy të dhëna ose në fjali ka gabime të vogla, por që janë të qarta

**0 pikë** - të tjera (nxënësi/nxënësja nuk merr pikë nëse ka më shumë gabime nga ajo që është nënvizuar, është shkruar ndonjë përgjigje tjetër ndryshe nga ajo që është kërkuar, nuk është dhënë asnjë lloj përgjigjeje)

#### **DETYRA 6.**

**1 pikë** - është rrethuar përgjigjja **1. Ernest Koliqi**

**0 pikë** - të tjera (është rrethuar përgjigjja 2 ose 3, janë rrethuar dy ose të tri përgjigjet, nuk është rrethuar asgjë)

#### **DETYRA 7.**

**2 pikë** – nëse nxënësi/nxënësja ka rrethuar nën A) numrin 2. letërsi e shkruar, ndërsa ka dhënë përgjigjen dhe argumentuar atë nën B) Sepse i dihet autori, kurse letërsinë popullore e ka shkruar populli.

**1 pikë** – nëse ka dhënë përgjigje të saktë ose nën A) ose nën B)

**0 pikë** - të tjera (është shkruar ndonjë përgjigje tjetër ndryshe nga ajo që është kërkuar, nuk është dhënë asnjë lloj përgjigjeje)

#### **DETYRA 8.**

**1 pikë** - është rrethuar përgjigjja **2. kumbulla**

**0 pikë** - të tjera (është rrethuar përgjigjja 1, 3 ose 4, janë rrethuar dy ose të katër përgjigjet, nuk është rrethuar asgjë)

#### **DETYRA 9.**

**3 pikë** – nëse nxënësi/nxënësja ka rrethuar saktë të gjitha pohimet

**2 pikë** – nëse nxënësi/nxënësja ka rrethuar saktë 3 pohime

**1 pikë** nëse nxënësi/nxënësja ka rrethuar saktë 2 pohime

**0 pikë** nëse nxënësi/nxënësja ka rrethuar saktë vetëm 1 pohim ose nëse nuk ka rrethuar saktë asnjë pohim

Ishte hera e dytë që mbas kthimit në Shkodër vinte në shtëpi të dajave.		JO
Nji mur i ri, fort i naltë, i nxim prej kohet me kërqele të bardhë.		JO
Përtej atij muri në një kopësht të huaj ngrihej një kumbull.	PO	
Ngjyra e atij muri, jo fort të naltë, e bante Lecin me andrrue.		JO

#### DETYRA 10.

**1 pikë** - nëse nxënësi/nxënësja ka rrethuar: **4. personifikimi**

**0 pikë** - të tjera (është rrethuar përgjigja 1, 2 ose 3, janë rrethuar dy ose të katër përgjigjet, nuk është rrethuar asgjë)

**Vërejtje:** detyra nr. 10 për shkak të gabimit teknik në test ka 2 pikë e duhet të ketë **1 pikë**

#### DETYRA 11.

**2 pikë** – nëse nxënësi/nxënësja ka shkruar: **dhjetëvjetësh; në atë pasdite; më të ëmbla; fëmijërisë së largët.**

**1 pikë** – nëse janë dhënë **të paktën dy përgjigje të sakta**

**0 pikë** - të tjera (është shkruar ndonjë përgjigje tjetër ndryshe nga ajo që është kërkuar, nuk është dhënë asnjë lloj përgjigjeje)

#### DETYRA 12.

**1 pikë** - nëse nxënësi/nxënësja ka shkruar: **Në shkallën pohore.**

**0 pikë** - të tjera (është shkruar ndonjë përgjigje tjetër ndryshe nga ajo që është kërkuar, nuk është dhënë asnjë lloj përgjigjeje)

#### DETYRA 13.

**2 pikë** - Nëse nxënësi/ nxënësja e ka shkruar: **Drita e ditës - kryefjalë; mbi tjegulla – rrethanor vendi; e shtëpive - përcaktor**

**1 pikë** – nëse nxënësi ka shkruar 2 përgjigje të saktë

**0 pikë** – 1 përgjigje të saktë

**Vërejtje:** detyra nr. 13 për shkak të gabimit teknik në test ka 1 pikë e duhet të ketë **2 pikë**

#### DETYRA 14.

**1 pikë** – është rrethuar përgjigjja **1. dëshirore**

**0 pikë** - të tjera (është rrethuar përgjigjja 2 ose 3, janë rrethuar dy ose të tri përgjigjet, nuk është rrethuar asgjë)

#### DETYRA 15.

**2 pikë** - nëse nxënësi/ nxënësja e ka shkruar nën **A) lidhore** dhe nën **B) lexonte**

**1 pikë** – nëse nxënësi/ nxënësja ka shkruar saktë vetëm një përgjigje ose nën A) ose nën B)

**0 pikë** - të tjera (është shkruar ndonjë përgjigje tjetër ndryshe nga ajo që është kërkuar, nuk është dhënë asnjë lloj përgjigjeje)

#### DETYRA 16.

**2 pikë** - nëse nxënësi/ nxënësja ka rrethuar saktë përgjigjen nën **A) 1. me bashkërenditje** dhe nën **B)** ka shkruar **lidhëza dhe**

**1 pikë** – nëse nxënësi/ nxënësja ka shkruar saktë vetëm një përgjigje ose nën A) ose nën B)

**0 pikë** - të tjera (është shkruar ndonjë përgjigje tjetër ndryshe nga ajo që është kërkuar, nuk është dhënë asnjë lloj përgjigjeje)

#### DETYRA 17.

**2 pikë** – nëse nxënësi/nxënësja ka shkruar: **e shtëpive – gjinore; mëngjesi – emërore; prej maleve – rrjedhore; e ditës - gjinore**

**1 pikë** – nëse nxënësi/nxënësja ka shkruar 2 përgjigje të sakta

**0 pikë** – nëse nxënësi/nxënësja ka shkruar një përgjigje të saktë ose nuk ka shkruar asgjë

#### DETYRA 18.

##### **Përgjigja e saktë:**

Nxënësi - emër

i mirë - mbiemër

zgjohet - folje

herët - ndajfolje

**2 pikë** – për 3 ose 4 përgjigje të sakta,

**1 pikë** – për të paktën 2 përgjigje të sakta,

**0 pikë** – nëse nxënësi/nxënësja gjen saktë vetëm një përgjigje ose nuk

shkruan asgjë.

**19.**

Skema për vlerësimin e hartimit – **18 pikë**

**Përmbajtja – 10 pikë**

Nxënësi/ ja:

▶ E titullon hartimin

**1 pikë**

▶ Shkruan ku e ka kaluar shkollimin e vet nëntëvjeçar

**1 pikë**

▶ Përshkruan shkollën (hapësirën: ndërtesën, klasën)

**1 pikë**

Nëse jep një përshkrim më të plotë dhe më me stil, merr **2 pikë**

▶ Përshkruan ditët e para në shkollë...

**1 pikë**

▶ Përshkruan mësuesin/ mësuesen, shokun, shoqen...

**1 pikë**

Nëse jep një përshkrim më të plotë dhe më me stil, merr **2 pikë**

▶ Përshkruan se si ka ndryshuar raporti i tij/ i saj ndaj shkollës/ ose bën përshkrimin e çasteve të tij/të saj të bukura ose të vështira...

**1 pikë**

Nëse jep një përshkrim më të plotë dhe më me stil, merr **2 pikë**

▶ Përshkruan çastet e tanishme në shkollë: shpreh keqardhje, gëzim, ndonjë pasiguri para çfarëdo risie...

**1 pikë**

**Gjuha dhe struktura e tekstit - 8 pikë**

Leksiku	Gramatika dhe drejtshkrimi	Lidhshmëria	Struktura e tekstit
<p>→ të shprehurit e qartë dhe të saktë, zgjedhja përkatëse e fjalëve, përdorimi i figurave stilistike</p> <p><b>2 pikë</b></p>	<p>→ respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, formave gramatikore, kongruencës; rumbullakimi kuptimor i fjalisë, renditja e saktë e fjalëve në fjali)</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p>→ respektimi i normës drejtshkrimore (përdorimi i drejtë i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe i shenjave themelore të pikësimit, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen</p>	<p>→ renditja e natyrshme e të dhënave të ofruara, lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit dhe pjesëve të tij</p> <p><b>1 pikë</b></p>	<p>→ përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe formës së tekstit strukturës së tij logjike (e ndan hyrjen, zhvillimin dhe përfundimin)</p> <p><b>1 pikë</b></p>

	<p>e fjalëve në fund të rreshtit)</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 4 pikë</b></p>		
<b>Leksiku</b>	<b>Gramatika dhe drejtshkrimi</b>	<b>Lidhshmëria</b>	<b>Struktura e tekstit</b>

<p>→ të shprehurit e qartë dhe të saktë, zgjedhja përkatëse e fjalëve, por pa përdorimin e figurave stilistike</p> <p><b>1 pikë</b></p>	<p>→ respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet semantike...)</p> <p><b>1 pikë</b></p> <p>→ respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të vogla (gabimet e vogla në shenjat e pikësimit: presja te fjalitë e ndërmjetme, inversioni, te fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit)</p> <p><b>1 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>		
---	--	--	--